



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 15 të Ligjit nr. 2003/14, për planifikimin hapësinor, nenit 11 të Ligjit nr. 03/L-106, për ndryshimin e Ligjit për planifikim hapësinor, të nenit 17, paragrafi 1, shkronja **b** të Ligjit nr. 03 L-040, për vetëqeverisje lokale, (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”) nr. 28/2008 dhe të nenit 15.1, shkronja **b** të Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të datës 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 29.12.2011, merr

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E PLANIT RREGULLUES PËR LAGJEN “MEDRESE - QAMËRIA”
NË PRISHTINË

Neni 1

Miratohet Plani rregullues për lagjen “Medrese – Çamëria” në Prishtinë.
Plani, nga paragrafi 1 i këtij neni, përbëhet nga pjesa tekstuale dhe pjesa grafike, të cilat paraqesin pjesë përbërëse të këtij vendimi.

Neni 2

Rregullimi dhe realizimi i hapësirës së përfshirë brenda kufijve të Planit rregullues, nga neni 1 i këtij Vendimi, do të bëhet nga organi kompetent komunal i Prishtinës për punë të planifikimit dhe urbanizmit, bazuar në kushtet urbanistike – teknike, të përcaktuara me plan, leje urbanistike dhe proceset përcjellëse në përputhje me ligjet e lartcekura.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi dhe fillon të zbatohet nga dita e miratimit të tij në Kuvendin e Komunës së Prishtinës.

Nga dita e miratimit të këtij Vendimi, pushojnë të vlejnjë planet ekzistuese urbanistike për kompleksin e përfshirë brenda kufijve të Planit rregullues të miratuar me këtë Vendim.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. nr.35-3202, më 29.12.2011

KRYESUESI I KUVENDIT
Sami Hamiti, ecc. i dipl.